



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 15 DHE 23 TETOR 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. I 23. OKTOBRA 2015. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetin mendor,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri,
6. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.
7. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,
8. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore,
9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të RTK-së nga komuniteti serb,
10. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za skupštinska pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Drugo razmatranje N/zakona o mentalnom zdravlju,
5. Drugo razmatranje N/zakona o zaštiti dojenja,
6. Imenovanje člana Rukovodećeg odbora Sudskog instituta Kosova,
7. Imenovanje člana Saveta za besplatnu pravnu pomoć,
8. Imenovanje člana Komisije za imovinske zahteve,
9. Formiranje Ad hoc komisije za izbor jednog člana Borda RTK-a, iz redova srpske zajednice,
10. Predlog parlamentarnih grupa za zamenu članova u parlamentarnim komisijama.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

(Mbledhja nuk filloi për shkak të gazit lotsjellës, të hedhur nga opozita, në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.)

* * *

E premte, 23 tetor 2015

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 15 tetor 2015

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Nëse ka mundësi të ulemi të gjithë!

(Reagime nga salla)

I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

(Fishkëllima nga salla)

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Ramush Haradinaj e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, i nderuar deputet!

RAMUSH HARADINAJ: Nuk po të shoh, a je këtu? Nuk po të shoh!
Sa deputetë i ka Parlamenti, se po më duket më shumë ka sot. A jeni deputetë edhe ju djem, a?
Ani, s'ka dert!

O kryetar, më mirë çohu ngadalë se nuk të ka mbetur vend këtu. Çohu me këta horra tu e dil prej këtu!

KRYETARI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e dytë:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. A ka pyetje parlamentare? Ju lutem, pak më shumë dinjitet!

(Reagime nga salla)

Me aq sa po shoh, nuk ka pyetje parlamentare.

(Reagime nga salla)

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Të nderuar deputetë,

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancës plenare, të mbajtur më 17 e 22 shtator dhe 1 e 8 tetor 2015? Nëse nuk ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 17 e 22 shtator dhe 1 e 8 tetor 2015.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetin mendor

Ju kisha lutur deputetë për një pauzë të shkurtër. Më pas vazhdon seanca plenare...!

(Reagime dhe debat nga salla ndërmjet deputetëve të pozitës dhe opozitës)

(Hedhje e gazit lotsjellës nga deputetët e grupeve parlamentare të opozitës në sallën e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.)

* * *

Vazhdimi i seancës plenare, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Mirëmbërëma, të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,
Më lejoni ta vazhdojmë seancën në këto rrethana në të cilat jemi, në një sallë brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Aktualisht brenda sallës janë 65 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i kemi kushtet për ta vazhduar seancën.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetin mendor

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për shëndetin mendor dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zonjën Flora Brovina, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

Të nderuar deputetë, e kemi zërimin dhe Sekretaria do ta sjellë mikrofonin te ai që e kërkon fjalën.

Fjalën e ka zonja Flora Brovina!

Atëherë, në mungesë të pranisë së zonjës Brovina, fjalën e ka zoti Fadil Beka, në emër të Komisionit FunkSIONAL.

FADIL BEKA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,
Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka analizuar dhe e ka amendamentuar këtë projektligj dhe në mënyrë unanime është votuar, kështu që presim edhe nga deputetët që ta miratojnë, përkatësisht ta votojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Beka!
Pas paraqitjes së këtij raporti nga Komisioni FunkSIONAL, të drejtën për diskutime e kanë komisionet e përhershme, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesi i Qeverisë dhe deputetët.

Ju lus, kush e do fjalën?

(Ndërhyrje)

Nëse dëshirojnë, ta keni parasysh që të shkojmë në bazë të Rregullores.

Atëherë, kush e dëshiron fjalën?

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 42 amendamente.

Ne do të vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL.

Këtu janë 42 amendamente dhe po e shoh vullnetin tuaj. Në qoftë se dëshironi shkojmë nga 1 - 42, me një votim formal - kush është për, kundër, abstenim?

Pra, a ta bëjmë këtë mënyrë të votimit?

A ka kush kundër?

Të pranishëm janë 65 deputetë.

Atëherë, vazhdojmë me votimin.

Pra, me 65 vota për kalojnë amendamentet e propozuara nga 1 deri në 42.

I nderuar zoti Grabovci, urdhëro! Urdhëroni, merreni mikrofonin!

ADEM GRABOVCI: Nëse ka 2 amendamente të propozuara edhe nga deputetët, atëherë duhet të hidhen të dyja në votim, ndërsa nëse nuk ka amendamente të dyfishta, atëherë shkojmë me atë votim dhe jemi dakord të shkojmë me një votim.

KRYETARI: Të gjitha janë të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, ta kemi parasysh.

Pra, edhe një herë: Kush është për këto amendamente?
Ju lutem, le t'i numërojë Administrata kush është për?

Pra, 65 deputetë janë të pranishëm dhe për janë 65 deputetë!

Kundër nuk ka!
Abstenim nuk ka!

Tani e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

I kisha lutur deputetët të përgatiten të gjithë për votim. Votojmë tash!

Kush është për?

Në sallë janë 65 deputetë!

1 është kundër!

Atëherë, 62 deputetë kanë votuar për, 1 kundër dhe 2 kanë abstenuar.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi Ligjin për shëndetin mendor me 62 vota.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për të ushqyerit me qumësht gjiri dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie sociale, zotin Fadil Beka, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Urdhëroni, zoti Beka!

FADIL BEKA: I nderuar zoti kryetar!

Edhe ky projektligj, i cili ka diku 20 amendamente, në mënyrë unanime ka kaluar nga komisioni përkatës, prandaj i propozojmë Kuvendit, përkatësisht deputetëve të këtij Kuvendi që t'i miratojnë këto amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Meqë është leximi i dytë, të drejtën për ta marrë fjalën, në bazë të Rregullores, e kanë komisionet e përhershme, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesi i Qeverisë dhe deputetët.

E do dikush fjalën? Urdhëroni, i nderuar!

HATIM BAXHAKU: Ne i përkrahim të gjitha amendamentet e komisionit, përveç 1 apo 2 amendamenteve të deputetit Haxhiu, që nuk e ka përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, prandaj ato duhet të votohen veç e veç.

KRYETARI: Është amendamenti 6, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL?

HATIM BAXHAKU: Po, pa përkrahjen e Komisionit funksional, ndërsa 3 amendamentet e deputetit Haxhiu janë përkrahur nga Komisioni FunkSIONAL. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua ta falënderoj Komisionin për Shëndetësi për bashkëpunimin e treguar në këto amendamente në këtë projektligj dhe nga 4 amendamentet e propozuara, 3 janë me përkrahje të komisionit dhe janë amendamente të cilat e rregullojnë këtë fushë dhe këtë qëllim, prandaj ato janë amendamente me përkrahje të komisionit, me përjashtim të njërit prej amendamenteve, i cili ka implikime apo ngërthim edhe me Ligjin e punës, i cili mendoj se në të ardhmen do të kompletohet me plotësim-ndryshimin e Ligjit të punës dhe në veçanti me Ligjin për lehonat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dikush tjetër, e do fjalën? Nuk e do!

Atëherë i kemi gjithsej 20 amendamente.

Unë do ta ndaj amendamentin numër 6, i cili është propozuar nga deputeti Bekim Haxhiu, por nuk e ka përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL dhe, nëse dëshironi, unë mund ta lexoj.

Tërhiqet? Po, tërhiqet! Pra, tërhiqet amendamenti 6 dhe tash i kemi 19 amendamente, të cilat janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Do të shkojmë t'i votojmë të gjitha përnjëherë, pra 19.

Ka kundër? Nuk ka!

Ka abstenim?

Pra, 65 deputetë jemi për.

Tani shkojmë e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

A ka kundër? Nuk ka!

Abstenim, a ka?

Atëherë Konstatohet se me 65 vota për Kuvendi e miratohet Ligji për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri.

6. Emërimi i anëtarit të Këshillit drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Komisioni Funkcional për Legjislacion, në bazë të Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit të ri të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar emërimin e kandidatit Elbasan Dervishaj.

E do fjalën përfaqësuesi i Qeverisë, si propozues? Nuk e do fjalën!

Grupi Parlamentar i LDK-së, e do fjalën?

Në emër të Komisionit, fjalën e ka Selviqe Halimi! Urdhëro!

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Partia Demokratike e përkrah propozimin e komisionit që Elbasan Dervishaj të jetë anëtar i Këshillit...

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zoti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar propozimin që Këshilli Drejtues i Institutit Gjyqësor të Kosovës të plotësohet me një anëtar. Në seancat e kaluara ne i kemi miratuar propozimet, e ky është një propozim që ka mbetur i përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë, kështu që edhe ne e përkrahim dhe vota jonë do të jetë pro. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje” nuk është këtu. Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk është këtu. Grupi Parlamentar Lista serbe nuk është këtu. Grupi Parlamentar “Nisma” nuk është këtu. Grupi Parlamentar “6+”?

MYFERA SHINIK: Këtu! Edhe grupi “6+” e përkrah.

KRYETARI: Faleminderit, zonja Myfera!

Deputetë, a ka dikush...? Jo.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për emërimin e zotit Elbasan Dervishaj anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, i propozuar nga Qeveria e Kosovës.

Lus deputetët të përgatiten për votim. Votojmë! Kush është për Elbasan Dervishajn? Kush është kundër? Kush abstenon? Me 65...

Konstatohet se 62 deputetë kanë votuar për, prandaj Kuvendi e emëroi zotin Elbasan Dervishaj anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës me mandat dyvjeçar.

7. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas

Komisioni për Legjislacion, në pajtim me Ligjin për ndihmë juridike falas ka shqyrtuar propozimet lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj zonjën Selviqe Halimi, që në emër të Komisionit Funkcional, ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Legjislacion i ka shqyrtuar të gjitha propozimet për anëtarë të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas, mirëpo në ndërkohë pas aprovimit nga komisioni ka qenë kontestues propozimi nga Ministria e Drejtësisë dhe kërkojmë nga deputetët që ta tërheqim nga rendi i ditës në tërësi këtë propozim, këtë listë, që ta rishqyrtojmë edhe një herë në komision dhe të konsultohemi edhe me Ministrinë e Drejtësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, ky ishte qëndrim edhe i partisë. Qeveria urdhëro, përfaqësuesi i Qeverisë, zoti Hajredin Kuçi, ministër i Drejtësisë.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ne e kemi tërhequr propozimin, jo që ka qenë kontestues, sa për të sqaruar, dhe besoj që duhet të tërhiqet tërë propozimi dhe pika e rendit të ditës. Tërhiqet kjo pikë e rendit të ditës për një mbledhje tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, e tërheqim këtë pikë të rendit të ditës? E tërheqim, Qeveria e ika rënë pishman.

8. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin lidhur me këtë çështje.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Selviqe Halimi, për arsyetimin e rekomandimit.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 27 korrik 2015, e shqyrtoi propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme dhe i rekomandon Kuvendit që i propozuari nga Gjykata Supreme, zoti Avdullah Aliu, të jetë anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore.

KRYETARI: Faleminderit! Tani, radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Urdhëro zonja Selviqe, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit!

Gjithashtu, edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah kandidatin Avdullah Aliu që të jetë anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

E para, më duhet të bëj një sqarim për pikën paraprake, nëse më lejohet, sepse duhet të theksohet që tërhiqet për t'u shqyrtuar në komision, e jo se tërhiqet prapa i gjithë propozimi, sepse propozimet tjera vijnë nga ministritë tjera dhe nga Shoqëria Civile, apo edhe Gjykata Supreme. Domethënë, tërhiqet për shqyrtim vetëm propozimi i Ministrisë së Drejtësisë, të cilët e kanë tërhequr propozimin e tyre dhe kanë kërkuar që kjo të shtyhet deri në takimin e radhës.

Ndërsa, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i jep përkrahje propozimit që ka ardhur nga Gjykata Supreme për profesorin Avdullah Aliu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Merret parasysh, megjithëse ne e tërhoqëm për sot, po le të futet edhe në protokoll në formën të cilën e tha deputeti, le të jetë edhe qëndrim zyrtar.

Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” nuk është këtu. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk është këtu. Grupi Parlamentar “Nisma” nuk është këtu. Lista serbe nuk është këtu.

OK, këtu është. Nga “6+”-i, urdhëro zonja Myfera Shinik.

MYFERA SHINIK: Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah kandidatin Avdullah Aliu.

KRYETARI: Faleminderit, zonja Myfera! Deputetë, a ka dikush diskutim? Nuk ka!

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Pra, zoti Avdullah Aliu është i propozuar. Lus deputetët të përgatiten për votim. Kush është për? Faleminderit!

Kush është kundër? A ka?... Xhavit Haliti abstenon. Janë 61 vota për, një abstenim.

Konstatohet se Kuvendi e emëroi zotin Avdullah Aliu anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore me mandat njëvjeçar.

9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 shtator 2015, ka kërkuar nga grupet parlamentare që deri në seancën plenare t'i propozojnë deputetët për kryetarë, zëvendëskryetarë

dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve. Grupi Parlamentar i Listës serbe për zëvendëskryetar të parë të komisionit e ka propozuar deputetin Sërgjan Popović. Ftoj kryetarët apo përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të Komisionit ad hoc.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që ta propozojë një deputet apo deputete për kryetar të komisionit dhe një deputet apo deputete për anëtar të komisionit.

Urdhëro, zoti Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e propozon për kryetar të komisionit Xhevahire Izmakun dhe për anëtar të komisionit Zenun Pajazitin.

KRYETARI: E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që t'i propozojë dy deputetë për anëtarë të komisionit.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne i propozojmë Sali Morinën dhe Sadri Feratin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", nuk është këtu; Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, nuk është këtu; Grupi Parlamentar "Nisma", nuk është këtu, Grupi Parlamentar "6+" që ta propozojë një deputet për anëtar të komisionit.

MYFERA SHINIK: Grupi Parlamentar "6+" e propozon deputetin zotin Kujtim Paçaku.

KRYETARI: Faleminderit! I kemi të gjitha propozimet. Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim. Urdhëro zoti Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: ... *(nuk dëgjohet diskutimi)*...

KRYETARI: Edhe një herë, Lista serbe tashmë e ka bërë propozimin për zëvendëskryetar të parë të komisionit, deputeti Sërgjan Popović, ta kemi parasysh. I kemi të gjitha propozimet nga grupet parlamentare që janë të pranishme.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Kush është për propozimet? Kush është kundër? A ka abstenim?

Konstatoj se në votim morën pjesë 62 deputetë dhe votuan për. Nuk ka kundër, nuk ka abstenim.

Kuvendi i miratoi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb.

Kërkohet nga Komisioni ad hoc që të veprojë në përputhje me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

10. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka propozuar deputetin Glauk Konjufca anëtar në Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme, në vend të deputetes Puhije Demaku.

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” i ka propozuar zëvendësimet, si në vijim: Deputetja Valdete Bajrami propozohet anëtare në Komisionin Parlamentar për Legjislacion, në vend të deputetit Fatmir Limaj; deputeti Enver Hoti propozohet anëtar në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetes Valdete Bajrami.

Të nderuar deputetë,

Kërkoj nga ju që nëpërmjet një votimi formal, me ngritje dore, të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe të Grupit Parlamentar “Nisma”. Votim formal, është rregull, apo e marrim vetëm kush është kundër. S’ka kundër, s’ka abstenim.

Konstatoj se Kuvendi i miratoi propozimet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe të Grupit Parlamentar “Nisma për Kosovën” për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Me këtë i mbyll punimet e seancës së sotme. Mirupafshim në seancën e radhës! Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*